


CEL Kosova dhe Universiteti i Prishtinës, Fakulteti Filozofik,
Departamenti i Sociologjisë

Nevojat dhe sfidat e studentëve të komunitetit LGBTQI+ në Universitet



Hulumtuese: Qëndresë Deda & Elira Shatri
Mentore: Prof. Dr. Linda Gusia
Nëntor, 2025

QENDRA PËR BARAZI DHE LIRI TË KOMUNITETEVE LGBT NË KOSOVË (CEL)

HULUMTUESE: QËNDRESË DEDA & ELIRA SHATRI

MENTORE: PROF. DR. LINDA GUSIA

COPYRIGHT © CENTRE FOR EQUALITY AND LIBERTY TË GJITHA TË DREJTAT E REZERVUARA. ASNJË PJESË E KËTIJ PUBLIKIMI NUK MUND TË RIPRODHOHET, TË RUHET OSE TË TRANSMETOHET NË ÇFARËDO FORME ELEKTRONIKE, MEKANIKE FOTOKOPJUESE, INCIZUESE APO NDRYSHE, PA LEJEN PARAPRAKE TË CEL KOSOVA.

Klauzolë e përgjegjësisë

Ky publikim u financua nga Ambasada e Holandës në Kosovë, Ambasada e Dukatit të Madh të Luksemburgut dhe Global Fund for Women, dhe është bashkëpunim me Universitetin e Prishtinës. Përmbatja e publikimit është përgjegjësi e vetme e CEL Kosova dhe nuk reflekton domosdoshmërisht pikëpamjet e partnerëve dhe donatorëve.

Abstrakti

Fillimi i studimeve universitare është periudhë e formimit dhe pjekurisë, ku nga individi pritet më shumë vetëdije, vëmendje, përgjegjësi e punë individuale, por edhe bashkëpunim e punë grupore. Komunikimi pa paragjykime dhe barazia mes studentëve mbeten thelbësore për punë e hulumtim dhe për përvojën akademike në tërësi.

Megjithatë pasi thënë poetikisht në universitet “dija na mbledh të gjithëve” kushdo që jemi e ngado që jemi, e ligjërisht na ofrohet barazi, pas analizimit të të dhënave kemi vërejtur se në hapësirën universitare shpesh hasen fenomene që ndikojnë negativisht në këtë zhvillim, si racizmi, seksizmi, homofobia dhe transfobia. Ky hulumtim në një pjesë të problemeve tek përvojat e studentëve LGBTI+ në Universitetin e Prishtinës, me synim që të kuptojë mënyrën se si ata e përjetojnë mjedisin universitar, mardhëniet ndërpersonale dhe raportin e tyre me hapësirën institucionale e shoqërore të universitetit.

Për shkak të kufizimeve kohore dhe numrit të intervistave, përzgjedhja e të dhënave është bërë duke pasur parasysh përfaqësimin sa më të drejtë të ndjenjave dhe përvojave subjektive të pjesëmarrësve në raport me hapësirën universitare, përmes një qasjeje biografike që i jep rëndësi mënyrës se si ata tregojnë dhe kuptojnë përvojat e tyre personale.

Fjalët kyçe: LGBTI+, Eksperienca Queer, Vështirësitë, UP, Stigmatizim, Identiteti gjinor.

Hyrje

Koha e fillimit të studimeve në universitet është periudhë formësuese dhe transformuese për studentët. Duke mos e përgjithësuar e njëjtësuar moshën, megjithatë sidomos në studimet BA, studentët janë pjesë e moshës pasadoleshente, kohë kur është normale të ndryshojmë raportin me veten dhe me të tjerët, të bëhemi dhe ç'bëhemi për të tjerët dhe për veten

Pavarësimi dhe individuimi, që shpesh lidhen edhe me fillimin e pavarësisë ekonomike (rroga e parë, dhoma e parë me qira, etj.), bëjnë që për të rinjtë këto të jenë copëza të riteve të kalimit që sjellin edhe hamendësimin, pyetjen (questioning), njohjen e seksualitetit, si dhe dyshimin, forcimin apo fluiditetin e identitetit gjinor.

Kjo periudhë përkon me kohën e fillimit të studimeve në universitet, kohën e zgjedhjeve të para për veten, të pritshmërive personale dhe shoqërore ndaj individit. Megjithëse nuk ka kohë e afat për vënien në pyetje e rizbulimin e identitetit gjinor dhe seksual (rrugëtimi vazhdon gjatë gjithë jetës, por prapëseprapë kjo kohë ka intensitetin e transformimit të shtyrë nga ndryshimet e natyrës biologjike, sociale e psikologjike që përjetohen nga individi apo imponohen nga shoqëria.

Hulumtimi për përvojat e studentëve të grupit LGBTQIA+ në Universitetin e Prishtinës e bën të rëndësishëm kombinimi i disa faktorëve, ndër ta: Shoqëria jonë, si një shoqëri në tranzicion dhe post-tradicionale, shfaq ende elemente të gjuhës së urrejtjes në hapësirën online dhe hapësirën fizike, ndërsa seksizmi dhe homofobia mbeten pjesë e humorit të zi dhe e gjuhës së përditshme popullore.

Kjo mënyrë e komunikimit shpesh vazhdon të përdoret natyrshëm edhe në ambiente institucionale si vendi i punës, shkolla dhe universitete, gjë të cilës nuk i shpëton as Universiteti i Prishtinës. Neutralizimi i gjuhës së urrejtjes në praktikë, i rifyson stereotipet dhe paragjykimet për komunitetin LGBTQIA+ dhe çdo pjesëtar të komuniteteve të marginalizuara dhe në fund nuk përfundon vetëm si gjuhë, por është edhe pjesë e jetës së përditshme në mënyrën se si tëhuajësohen (othering) grupet e marginalizuara duke u parë si shumë të ndryshme nga vetja dhe të rrezikshme.

Metodologjia

MBLEDHJA E TË DHËNAVE

Të dhënat u mblodhën përmes intervistave gjysmë të strukturuar. Pyetjet fokusohen në:

- përvojat personale dhe sfidat në mjedisin universitar,
- perceptimet mbi mbështetjen institucionale,
- rëndësinë e aktiviteteve simbolike, si ngritja e flamurit të krenarisë,
- nevojat e studentëve për përfshirje dhe mbështetje.

ANALIZA E TË DHËNAVE

Të dhënat e intervistave janë analizuar në mënyrë cilësore, duke identifikuar temat kryesore dhe modelet e përsëritura që lidhen me klimën sociale, mbështetjen institucionale, sfidat dhe nevojat e studentëve LGBTI. Krahasimet ndër-fakultete ndihmojnë në nxjerrjen e përfundimeve mbi ndikimin e kontekstit akademik në përvojën e studentëve.

KONSIDERATAT ETIKE

Hulumtimi është kryer duke respektuar standardet më të larta etike në kërkimin social:

- Anonimiteti i pjesëmarrësve është ruajtur në çdo fazë të hulumtimit. Emrat dhe identitetet e tyre janë koduar për të shmangur çdo rrezik të identifikimit.
- Pjesëmarrësit janë informuar paraprakisht për qëllimin e studimit dhe kanë dhënë pëlqimin

e tyre të informuar për t'u përfshirë në intervistë.

- Të dhënat janë përdorur vetëm për qëllime akademike dhe janë trajtuar me konfidencialitet të plotë.

Afati për përfundimin e hulumtimit ishte përcaktues për mënyrën dhe çasjen e planifikuar për nxjerrjen dhe analizimin e të dhënave. Kontaktet i kemi realizuar nga sygjyerimet e marra nga mentorja dhe profesorët e tjera të angazhuara në projekt. Kemi realizuar gjithashtu edhe dy intervista të tjera me kontakte të krijuara nga rrjetëzimi ekzistues personal i hulumtueseve.

Kemi pasë synim të përfshijmë gjenerata të ndryshme studentësh dhe ish-studentësh, pjesëtarë të gjinive të ndryshme dhe student të departamenteve dhe gjeneratave të ndryshme, me qëllim që të shqyrtojmë ngjashmëritë dhe dallimet mes përvojave të tyre.

Para realizimit të intervistës pjesëmarrësit janë informuar përmes emailit për natyrën e hulumtimit. Pasi ata kanë konformuar pjesëmarrjen jemi takuar për të realizuar intervistën, e cila fillon të incizohet vetëm pasi edhe njëherë konformohet “consent” - “leja” për incizim dhe përdorim konfidencial – anonim të të dhënave.

Gjithsej kemi realizuar gjashtë intervista: tri me ish-student të Fakultetit Filozofik, me një student të Shkencave Matematiko-Natyrore, me një student të Fakultetit Filozofik, dhe me një profesoreshë të Universitetit të Prishtinës.

Dy nga intervistat janë realizuar online për shkak të kohës së shkurtër gjatë të cilës na është dashur të realizojmë grumbullimin e të dhënave dhe poashtu pasi njëri nga pjesëmarrësit jeton jashtë vendit.

Gjatë tri intervistave kemi qenë prezent të dy hulumtueset, ndërsa dy intervistat e realizuara online e kemi bërë ndarjen e informatave të marra me njëra - tjetrën.

Çdo intervistë është planifikuar paraprakisht për t'u vlerësuar si e rëndësishme edhe janë diskutuar pritshmëritë të cilat i kemi nga intervista apo thënë më mirë: të dhënat për të cilat po gjurmojmë.

Pas intervistave poashtu ka pasuar diskutim më të gjerë për informatat e marra dhe krahasim me informatat e tjera (kur kemi pasë më shumë se një intervistë).

Gjetjet e hulumtimit

Pas analizimit të të dhënave nga gjashtë intervistat e realizuara kemi arritur tek disa gjetje të cilat paraqesin përvojën personale dhe grupe të individëve LGBTI+ në Universitetin e Prishtinës, dhe gjithashtu nga një intervistë kemi pikëpamjen e gjendjes nga personeli akademik.

Një ndër çështjet e cila është identifikuar si problematike nga pjesëmarrësit e gjashtë intervistave është çështja e përdorimit të gjuhës homofobe e seksiste nga disa profesorë ose kolegë student.

Përdorimi i gjuhës seksiste dhe homofobe është i neutralizuar në kulturën tonë, si pjesë e humorit përçmues e të zi, e poashtu është pjesë e të zakonshmes në mënyrën se si i qasemi njëri tjetrit. Kur gjuhë e ngjashme me të përdoret në nivel institucional e universitar bëhet siptomatikë e tregimit të problemeve institucionale që tregojnë nivelin dhe mënyrën e seriozitetin e adresimit të çështjeve bazike të drejtave të njeriut në universitet.

Ngritja e flamurit të krenarisë në oborrin e Universitetit të Prishtinës shënoi një moment të rëndësishëm simbolik. Si akt që për disa çaste i dha dukshmëri identiteteve të pa pranueshme në publik. Ngjarje të tilla simbolike, përkundër intensitetit të tyre, shpesh humbin ndikimin përballë praktikave të përditshme: komentet ofenduese online, gjuha diskriminuese, dhe heshtja institucionale në ambientet akademike kur individët marginalizohen.

Megjithatë, brenda përditshmërisë shpesh lindin edhe elemente të vogla pozitive që ruajnë gjallë shpresën dhe mundësinë e ndryshimit. Një profesoreshë që fton ligjërues nga komuniteti për të folur hapur me studentët (praktikë e cila filloi të ndodhte rreth 10 vite më parë në Departamentin e Psikologjisë), një student që gjen guximin të rrëfejë përvojën e tij, një bashkëbisedim që përmbys bindje të rrënjosura prej vitesh,...janë pikërisht këto gjeste të vogla njerëzore që e bëjnë universitetin të marrë frymë ndryshe. Ato tregojnë se transformimi social nuk ndodh përmes institucioneve të mëdha, por përmes ndërveprimeve të përditshme ku secili nga ne është agjent i ndryshimit e ndryshimi që e përjetojmë nga brenda ndikon në ndryshimet e jashtme dhe anasjelltas.

Derisa në komunikim me njëri tjetrin ndryshueshmëritë tona jo domosdoshmërisht njëjtësohen, mund të jemi të ndryshëm dhe të veçantë por me njohje, empatia dhe pranimi për tjetrin vjen natyrshëm dhe i pa imponuar.

Nga bisedat me studentë, kemi pasë një sugjerim, për organizime jashtë fakultetit, netë filmash që ndikojnë në “community building” dhe ndjenjës së përkatësisë, por që ngjarjet të mos jenë domosdoshmërisht vetëm për LGBTI por për të gjithë.

Të qenit queer në hapësirat universitare kërkon guxim të përditshëm, një akt i vogël rezistence ndaj përjashtimit.

Por ky guxim individual duhet të shoqërohet nga mbështetje institucionale që nuk e lë askënd vetëm!

Të qenit queer në hapësirat universitare kërkon guxim të përditshëm, një akt i vogël rezistence ndaj përjashtimit. Por, ky guxim individual duhet të shoqërohet nga mbështetje institucionale që nuk e lë askënd vetëm. Nevojiten politika të qarta kundër diskriminimit, mbështetje psikologjike për studentët dhe trajnim i vazhdueshëm për stafin akademik mbi çështjet e diversitetit. Vetëm kështu universiteti mund të përmbushë misionin e tij: të mos jetë thjesht një vend ku mësohet për barazinë, por një hapësirë ku barazia jetohej realisht, çdo ditë.

Duke ardhur nga një qytet më i vogël, shumë studentë LGBT e shohin Prishtinën dhe Universitetin e saj si hapësira më të hapura dhe më tolerante krahasuar me mjediset nga vijnë. Por për disa, këto pritshmëri përplasen shpejt me realitetin e përditshëm.

Një student përshkruan se që në muajin e parë të studimeve, ai u trajtua ndryshe nga kolegët dhe u etiketu si “më ndryshe”. Përveç kësaj, ai përballlej me sharje të drejtpërdrejta nga disa kolegë në grupe joformale të studentëve, për shkak të identitetit të tij.

Hapësirat joformale, ku normalisht pritet të ketë dialog dhe diskutim, nuk janë gjithmonë të sigurta. Studentët raportojnë se profesorët në disa raste kanë përdorur terma fyese si “peder” ose kanë përqeshur personat transgjinjorë, duke reflektuar një sfidë të vazhdueshme mes pritshmërive për hapësira të sigurta dhe realitetit të sjelljeve diskriminuese.

Përvoja e tij tregon se edhe në qendrat urbane dhe institucionet akademike, ku supozohet se ekziston një nivel më i lartë i tolerancës, grupet e marginalizuara mund të përballen me paragjykime të qarta dhe fshehta.

“Duke qenë person LGBT nga një qytet tjetër, gjithmonë kam pasur perceptimin se Prishtina, si kryeqytet, dhe Universiteti, si vend i dijes (veçanërisht ai i shkencave sociale), janë hapësira më të hapura për grupet e marginalizuara, krahasuar me qytetin dhe rrethin prej nga vij”.

Në një intervistë tjetër me një student të Fakultetit të Shkencave Matematiko-Natyrore, i njëjti ka qenë edhe pjesëmarrës gjatë ngritjes së flamurit LGBTQI+ në hapësirën universitare. Ai ndan përvojat e tij të përditshme të cilat pasqyrojnë presionin e paragjykimeve. Këto përvoja nuk shfaqen gjithmonë si ofendime të drejtpërdrejta, por manifestohen përmes gjesteve të vogla, pyetjeve që në dukje janë të pafajshme si “Pse e ke vnu vathin, a e din që osht për çika?”

Në sallat e ligjëratave dhe korridoret e fakultetit, ai përballlet/ është palë e dëmtuar e mënyrës se si normat gjinore rregullojnë trupin. Ku: një vath, një rruzë, ose thjesht një mënyrë të qenurit “ndryshe” tërheq vëmendje dhe ngjall interpretime për personin.

Është simptomatikë e kohës mënyra se si është përshkruar përdorimi i mediave sociale nga dy nga pjesëmarrësit e intervistave. Kjo tregon ndikimin që e kanë mediat sociale në ditët e sotme dhe se si aktivizmi digjital luan rol direkt në mënyrën diskursin publik për çështje të caktuara.

Themeluesi i organizatës Queer Studentore rrëfen historinë e fillimit të veprimtarisë së organizatës. Ai tregon se nisma fillestare filloi me hapjen e një llogarie në Instagram, përmes së cilës synohej krijimi i një hapësire virtuale për studentët queer. Pa njohuri paraprake në fushën e dizajnit apo artit figurativ, ai e dizajnoi vetë logon e organizatës, si një mënyrë për të shprehur vizualisht identitetin kolektiv të saj.

Për arsye sigurie dhe për të shmangur identifikimin e tij me organizatën, ai hezitoi të ndjekë llogarinë nga profili personal. Kontakti i parë erdhi nga një vajzë dizajnere, e cila ofroi ndihmë vullnetare në krijimin e logos dhe përmbajtjeve vizuale për rrjetet sociale. Themeluesi tregon se aktivitetet e para ishin të përqendruara në rritjen e dukshmërisë së organizatës përmes mediave sociale, si një mënyrë për të krijuar praninë dhe legjitimitetin e saj në hapësirën publike digjitale.

Në vijim, përmes këtij rrjeti kontakti, ata arritën të komunikojnë me një profesoreshë të Universitetit të Prishtinës, e cila në atë periudhë mbante pozitën e prorektore. Ajo tregon se kërkesa për ngritjen e flamurit të krenarisë në objektin e UP-së, e ardhur nga organizata Queer Studentore, ishte më e lehtë për t'u pranuar dhe për t'u përcjellë si nismë apo “trysni” nga vetë studentët, edhe pse organizata ishte ende në fazat fillestare dhe me një numër të vogël pjesëmarrësish.

“T’kujt janë ato dur?”, “Me ia djegë”, ose psh. “Ju thafshin durt”, nuk u pa kurgja ama paramendoje nëse isha pa unë çka kishin thanë.

Personi që mbajti flamurin gjatë aktit të ngritjes tregon se anëtarët u kujdesën që në postimet në rrjetet sociale të mos dallohej fytyra apo identiteti i tij, për arsye sigurie. Ai përmend se komentet fyese dhe agresive në Facebook, si: “T’kujt janë ato dur?”, “Me ia djegë”, ose psh. “Ju thafshin durtë”, patën ndikim emocional tek ai, duke shtuar se “unë i kqyrsha durt e mia...”. Ky përjetim tregon ndikimin që dhuna kibernetike dhe verbale ka në ndjenjën e trupit dhe në ndërtimin e identitetit.

Punëtorët teknikë që ndihmuan në vendosjen fizike të flamurit shprehën komente si: “A nuk gjetët naj flamur tjetër?”, të cilat pasqyrojnë formën e qëndrimeve homofobike që mbeten të pranishme në hapësirat institucionale.

Profesoresha tregon se ekipi ishte organizuar që publikimi i postimeve në Facebook të bëhej me kujdes, duke lejuar që mesazhi të përcillej publikisht, por duke bllokuar komentet në disa prej tyre për të shmangur diskutet negative dhe nxitjen e urrejtjes.

Një tjetër dimension i riprodhimit të gjuhës së urrejtjes shfaqet në hapësirat virtuale, ku urrejtja dhe paragjykimet shprehen përmes komenteve dhe reagimeve në rrjete sociale.

Një nga të intervistuarit rrëfen përvojën e tij si target i një “group cyberbullying” (praktikë e ngacmimit të një personi duke dërguar mesazhe ose duke postuar përmbajtje në mediat sociale me natyrë frikësuese, tallëse ose kërcënuese), ku rreth 80% e pjesëmarrësve të një grupi studentësh online kishin kontribuar me komente apo reagime ofenduese. Ky rast ilustron mënyrën se si hapësirat virtuale mund të shndërrohen në terrene të reja të përjashtimit social dhe të stigmatizimit të identiteteve queer.

I njëjti person tregon se përveç përvojës së dhunës simbolike në hapësirën digjitale, është përballur edhe me mungesë pranueshmërie në hapësirën fizike të Universitetit. Megjithatë, ai përmend një përvojë pozitive me një koleg student, i cili në fillim të studimeve kishte shfaqur qëndrime homofobike dhe paragjyquese ndaj komunitetit LGBTQ+, por pas ndërveprimeve të vazhdueshme dhe kontaktit personal me të intervistuarin, ndryshoi bindjet dhe qëndrimin e tij. Një rast i ngjashëm është raportuar edhe nga një tjetër pjesëmarrës, duke dëshmuar se ndërveprimi social dhe njohja e drejtpërdrejtë mund të kontribuojnë në transformimin e perceptimeve dhe reduktimin e paragjyqimeve ndaj komunitetit queer.

Përveç që gjuha e përdorur ndaj meje ka qenë tejet e rëndë, ajo që e ka bërë përvojën edhe më të sikletshme ishte fakti që ndodhi në praninë (virtuale) të pothuajse të gjithë studentëve të tjerë.

Nga intervista me një ish-student të Sociologjisë, ajo çka vihet në pah është vazhdimësia e diskriminimit të normalizuar brenda hapësirës universitare, ku gjuha e paragjykitit përdoret shpesh nga vetë profesorët, figura prej të cilave pritet të promovojnë barazi dhe respekt. Heshtja e studentëve dhe mungesa e raportimeve ndaj këtyre rasteve paraqet dukshëm mungesën e një sistemi të besueshëm institucional, ku viktimat e diskriminimit ndihen të pambrojtura dhe të pasigurta.

“Homofobia jo vetëm çështje individuale, por pjesë e një kulture të rrënjosur që riprodhon përjashtimin dhe frikën”.

Më tej, përmend rastin e vandalizimit të muralit queer në hapësirën e Universitetit, çka tregon se homofobia nuk është vetëm çështje individuale, por pjesë e një kulture të rrënjosur që riprodhon përjashtimin dhe frikën. Ky rast nënvizon nevojën urgjente për ndërhyrje institucionale, përmes edukimit, politikave mbrojtëse dhe mekanizmave të raportimit, në mënyrë që universiteti të shndërrohet në një hapësirë reale të sigurisë, pranimit dhe lirisë për të gjithë studentët, pavarësisht identitetit të tyre gjinor apo seksual. Siç thekson njëri nga të intervistuarit: “Pasi jam larguar nga UP, kam parë që është vandalizuar murali i dy personave queer në murin e Universitetit nga homofobë, që i bie se akoma ka probleme dhe në përgjithësi nuk është e pranueshme dhe e sigurt të jesh queer hapur në UP.”

Nga intervista me profesoreshën e cila është pjesë e stafit akademik të UP-së, dhe gjatë viteve të saj të punës ka punuar në dy departamente të Fakultetit Filozofik: Psikologji dhe Punë Sociale, e e cila poashtu ishte pjesë e stafit udhëheqës administrativ të UP-së, kemi kuptuar se ajo në një mënyrë po një tjetër, varësisht prej funksionit të punës ka vazhduar t’i adresoj çështjet e komunitetit LGBTI+ në UP.

Pa bujë dhe pa zhurmë, me strategji të qetësisë e veprimit, nga intervista e saj theksohet roli i veprimit të drejtpërdrejtë kudo që jemi për çështjet të cilat janë etikisht të rëndësishme për ne e të nevojshme për drejtësinë shoqërore.

“E maj men herën e parë kur i kom thirrë s’i kom tregu asni kolegut, as dekanit, se thojsha me ba me ditë m’thojnë diçka, ma nalin.”

Ajo thotë se vëren tek vetja e saj dallimin mes gjeneratave të profesorëve, thotë që disa profesorë kanë qenë në mbrojtje dhe mbështetje të studentëve LGBTI+, fillimisht për të “çarë rrugën” në UP, kanë qenë më të zëshme e agresive në reagime. Mënyrën se si ka vepruar për shembull: për t’i futur në kurrikulën shkollore çështjet LGBTI+ duke u dhënë studentëve shembuj konkret, partneriteti me CEL për ligjërues vizitorë në departamentin e Punës Sociale, puna praktike me LGBTI+ organizata, procesi i organizimit të ngritjes së flamurit të krenarisë në UP, të gjitha të përgatitura në heshtje strategjike e me gatishmëri për veprim të shpejtë.

Drejtimit në të cilat është e involvuar janë poashtu të rëndësishme për mirëqenien mentale të komunitetit në të ardhmen andaj mobilizimi i gjeneratave të reja me njohuritë e duhura në kohë është e nevojshme.

Ajo këshillon dhe dëshiron që veprimtaria e organizatës Queer Studentore dhe organizatave të tjera që merren me të drejtat dhe liritë e komunitetit duhet të shtrihet edhe në fakultetet tjera (psh. Fakulteti i Bujqësisë), që të kemi gjithpërfshirje edhe shpërndarje të informatës tek të gjithë studentët pavarësisht drejtimit.

Një ish student i Sociologjisë tregon përvojën e tij në hapësirën universitare, në rastet kur temë diskutimi ishin çështjet e gjinisë dhe seksualitetit, përvojat e tij janë të ndryshme, ideja që shpesh mund të shihesh apo perceptohesh si target, e bën që të jetë më i mbyllur dhe të mos e shprehë identitetin e tij lirshëm, por në klasë të ndryshme ku janë diskutu tema të tilla ka pasë përjetime diametralisht të kundërta.

Në një klasë, është ndier i pranuar dhe i përkrahur por në të njëjtën kohë edhe target nga kolegët e tij, në tjetrën kur është përmend gjuhë diskriminuese nuk ka hesht, edhe pse duke i marrë parasysh politikat e arsimit në Kosovë, një veprim i tillë nuk është marrë parasysh, lidhjet kolegjale, profesor me profesor.

“Saherë që është folë për LGBTI ka pasë reagime prej ma të ndryshmeve, edhe ma s’pakti masnej je ni rahat me “come out” ose me u shpreh se ti bohesh target, edhe nëse ki shumë njohuri për LGBTI edhe flet ti bohesh target, se fakti që po del

“Ah, ti koke”.

Është vërejtur dallim në nivelin e pranueshmërisë që ka përjetuar njëri nga të intervistuarit, gjatë përvojës së tij si student në raportet me kolegët dhe stafin akademik të Universitetit të Prishtinës.

Duke i krahasuar periudhat e studimeve në nivelin bachelor dhe master, ai supozon se ky ndryshim lidhet me disa faktorë shoqërorë dhe institucionalë. Një ndër arsytet e mundshme është fakti se gjatë studimeve në master ai tashmë ishte një figurë publike dhe kishte marrë pjesë aktive në avokimin për të drejtat e komunitetit LGBTI+ në media, çka mund të ketë ndikuar në perceptimin dhe qëndrimin e të tjerëve ndaj tij.

Një tjetër faktor që ai e përmend është grupi më i vogël i studentëve në nivel master, si dhe niveli më i lartë i formimit akademik dhe informimit të tyre në raport me çështjet gjinore dhe seksuale. Këta elementë kanë ndikuar që mjedisi në studimet master të jetë më i hapur dhe më pranueshëm, në krahasim me përvojën e tij në studimet bachelor, ku paragjykimet dhe stereotipet ishin më të theksuara.

I intervistuari gjithashtu përshkruan përvojën e tij lidhur me qasjen e stafit akademik dhe administrativ të Universitetit të Prishtinës pas procesit të ndryshimit të gjinisë. Në përgjithësi, ai e përshkruan këtë periudhë si pozitive dhe të pranueshme, duke theksuar se nuk ka përjetuar paragjykime të drejtpërdrejta dhe se sjellja e personave të tjerë ka mbetur e pandryshuar, pavarësisht transformimit të tij gjinor.

Duke qenë se i intervistuari i përket një gjenerate tjetër, mënyrat e informimit rreth ekzistencës së organizatave që mbështesin komunitetin LGBTI kanë qenë më të kufizuara si dhe ekzistenca e organizatave të tilla në vendin tonë ishte më e vogël. Ai përshkruan mënyrën se si ka rënë në kontakt me organizatën CEL, duke theksuar rolin e universitetit si hapësirë sociale ku studentët me ide, bindje dhe përvoja të ngjashme krijojnë rrjete mbështetjeje dhe shkëmbejnë informata. Përmes kësaj interviste, bëhet e dukshme rëndësia e universitetit si një ambient që mund të nxisë ndjenjën e përkatësisë dhe të sigurisë. I intervistuari ndalet gjithashtu te përvoja e pjesëmarrjes në Marshin e Krenarisë, ku takimi me disa nga profesorët e universitetit ka ndikuar në forcimin e vetëbesimit dhe në lehtësimin e procesit të “coming out”, duke e bërë më të natyrshme diskutimin e temave që lidhen me komunitetin LGBTI brenda hapësirës universitare.

Një tjetër e dhënë e rëndësishme është sugjerimi për zhvillimin e politikave shtetërore për shëndet mendor, specifikisht dhe të duhur për komunitetin. I njëjti supozon se do ta kishte më të lehtë nëse do të ekzistonte këto shërbime psikologjike kur ishte student e përballej me gjuhën fyese dhe denigruese në UP.

Sipas tij mungesa e qendrave të mirëfillta që ofrojnë mbështetje psikologjike në qytetet e Kosovës paraqet një sfidë serioze, sidomos për personat LGBTI që përballen me stres të shtuar social dhe emocional. Përpjekjet e organizatave të shoqërisë civile për të plotësuar këtë boshllëk institucional janë përshkruar si të pamjaftueshme dhe të pasiguruara financiarisht.

“T’drejtat e njeriut, shëndeti mendor, s’duhet me kon prioritet, e kto jon ajo mendësia e vjetër “hajt se ti po don me u dok sa ma “cool” e sa ma “in” e po thu jom t’u struggle me mental health”

Në kujtim të Anës, për Anën, për guximin e Anës (për të qenë Ana në UP)!

Shoqja e Anës kujton momente se si shoqja e saj ishte ndjerë jo rehat në ambientin e UP-së, rrethi shpesh ka qendru i heshtun, nuk ka folë por kanë përjashtu e largu me shikime.

Rëndësinë e ekzistencës së konsulencës (shërbimeve falas) të shëndetit mendor për student të UP- së e adreson edhe një nga të intervistuarat tona, studente e sociologjisë. Këtë nevojë e lidhë veçanërisht me përvojën e saj si pjesë e grupit të studentëve të cilët ishin në të njëjtën klasë ku njëra nga studentet përfundoi në vetëvrasje. E intervistuar pohon që disa nga universitetet private si p.sh UBT e kanë këtë shërbim dhe një zyre të tillë të qasshme për të gjithë studentët, dhe e njëjta e sheh si të nevojshme edhe për UP-në.

Ajo kujton momente se si shoqja e saj ishte ndjerë jo rehat në ambientin e UP-së, rrethi shpesh ka qendru i heshtun, nuk ka folë por kanë përjashtu e largu me shikime. Poashtu kujton që për të ka qenë sfiduese përdorimi i emrit të cilin e kishte të vënë në lindje dhe disa nga profesorët ndodhte që e thirrnin për të vërtetuar prezencën në fillim të orës, megjithëse ajo vazhdonte t'i informonte se është Ana. Ajo gjithashtu kujton edhe një tjetër moment të përdorimit të gjuhës fyese ndaj saj nga një tjetër student gjatë kohës kur ato po zbrisnin shkallëve. Këto ngjarje i kujton si pjesë ku e ndjera nuk është ndjerë mirë në ambientin e UP-së.

Të njëjtën e kemi pyetur nëse studentët e atij viti i adresojnë në hulumtime tema që kanë lidhje me çështjet LGBTI - ndërsa ajo përgjigjet se vetëm ajo e ka pasë një temë të tillë në lidhje me martesat e seksit të njëjtë dhe një kolege tjetër ndodh që i ndërlidh këto tema me feminizëm, por për grupin megjithëse janë studentë të sociologjisë këto tema apo temat feministe mbeten tabu apo studentët shprehin aversion ndaj tyre.

Për temën e vetëvrasjes thotë që është trajtuar nga disa studentë si temë hulumtimi nga qasja sociologjike por kur i ka ndodhur njëres nga studentet e klasës vetëm 2-3 persona i kanë ndihmu në përgatitjen e posterit përkujtimor, e për ndezjen e qirinjëve në Bubble kanë marrë pjesë vetëm dy shoqe të saj, ajo dhe një tjetër. Për ngushëllime kanë shprehë dëshirë pjesëmarrjeje edhe një grup më i madh i studentëve, por nuk ka ndodhë e pame.

Ajo poashtu përmend se disa nga profesorët të cilët janë më të vjetër janë edhe më konservativ dhe gjatë orëve të mësimi përdorin gjuhë jo të duhur gjatë ligjëratave që ka tone raciste, seksiste dhe homofobe.

Nga ky rrëfim del një nevojë e qartë për ndryshime strukturore dhe kulturore në universitet: krijimi i zyrave të qasshme për shëndetin mendor, trajnime për profesorët mbi diversitetin dhe respektin për identitetet e ndryshme, ndërtimi i një hapësire më përfshirëse dhe mbështetëse për studentët LGBTI dhe integrimi i temave të drejtat e njeriut në programin akademik.

Përfundim

Si emërues i përbashkët i intervistave, duke i krahasuar dhe pasë parasysh dimensionin kohor të zhvillimeve në Universitet, nga studentët dhe profesoresha pohohet që ka moderim të gjuhës së urrejtjes dhe sjelljeve jo të duhura nga stafi akademik në UP. Vazhdimësia e ekzistencës së gjuhës denigruese e stigmatizuese kërkohet të neutralizohet dhe rregullohet me ligj, duke e bërë të detyrueshëm për profesorët dhe stafin akademik trajnimin për çështjet LGBTI+ .

Konsiderojmë që në përgjigjet e marra kanë ekzistuar pohimet se atë cka po ndodh tash nuk do të ishte e mundur të ndodhte më herët (psh. Të vijë lirshëm në UP një person trans). Si të rëndësishme shihen veprimtaritë të cilat kanë ekzistuar në vazhdimësi: Shkolla për gjininë dhe seksualitetin, ngritja e flamurit.

Ajo që dëshirohet është konsistenca e vazhdimësisë së veprimtarive. Gjithashtu adresohet nevoja për ndihmë konkrete për studentët: strehim, bursë, ndihmë përmes këshillimit psikologjik.

Nevojitet një ndërhyrje më e strukturuar, përmes politikave të qarta universitare dhe ligjore që ndalojnë diskriminimin në bazë të orientimit seksual dhe identitetit gjinor. Një nga masat që propozohet është që trajnimi për çështjet e diversitetit gjinor dhe seksualitetit të bëhet i detyrueshëm për profesorët dhe stafin akademik. Kjo do të ndihmonte në ndërtimin e një vetëdijeje më të thellë për mënyrën se si gjuha, sjelljet dhe qëndrimet ndikojnë në përjashtimin apo përfshirjen e studentëve queer.

www.cel-ks.org

info@cel-ks.org

+383 49 701 499